



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

[Dt.12.09.2023]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(PARAPRAK)

OPERATORIT EKONOMIK “Vojsava Zenelaj” PF

Adresa: Tirane Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla Nr.2, kati i dyte

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur (mall).**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Blerje uniforma dhe veshje të tjera speciale” me Nr. reference REF-76673-08-02-2023** për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 67 datë 07 Gusht 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

- **Operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” pf me NUIS L12330004A**

Vlera e ofertës pa tvsh = 15.488.000 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë.

- **Operatori ekonomik “Bajro Bros” shpk me NUIS M113130290**

Vlera e ofertës pa tvsh = 0 (zero) lekë.

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- **Operatori ekonomik “Bajro Bros” shpk me NUIS M113130290**

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe të Kreut X, Nenit 82, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si mëposhtë:

Pas hapjes së ofertave, u konstatua se Operatori Ekonomik “Bajro Bros” nuk ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik, dokumentacionin e duhur ligjor, ekonomik dhe teknik dhe as mostrat fizike të kërkuara në ditën edhe orëen e hapjes së ofertave. Ky fakt i konstatuar u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave. Mungesa e dokumentacionit ekonomik, ligjor dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Sa më sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Operatorit ekonomik “Bajro Bros” shpk, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë të pavlefshme**.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Vojsava Zenelaj” pf**, me adresë: Tirane Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla Nr.2, kati i dyte, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 15.488.000 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë pa tvsh është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.